



Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, shkronja (d) dhe 40, paragrafi 2, shkronja (h), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e konform nenit 11, lidhur me nenin 28 paragrafi 2, pika (h), dhe 29, paragrafi 2, pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, e në mbështetje të nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat e ndarjes së çmimit “Ukë BYTYÇI” 01-Nr-16-5820, të datës 29.09.2011, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e propozimit të komisionit për ndarjen e çmimit “Ukë BYTYÇI”

Neni 1

Çmimi “Ukë BYTYÇI” për Udhëheqje të mirë, në sektorin privat i ndahet z. Arsim KABASHI i lindur 09.05.1985, në Krushicë të Ultë Komuna e Suharekës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës në Suharekë.

Neni 3


Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e takimit të Komisionit për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e çmimit “Ukë Bytyçi” për udhëheqje të mirë, mbajtur me datën 09.09.2022 në ora 11:00 në zyrën e Kryesuesit të Kuvendi të Komunës në Suharekë.

Të pranishëm në takim Komisioni ishin:

1. Bexhet Kuçi-----kryesues
2. Bulëza Kuçi-----anëtare
3. Mimoza Bajraktari-----anëtare
4. Enver Shabani-----anëtar
5. Aida Kuçi-----anëtare

Kryesuesi i komisionit njoftoi qe mundem me vazhduar me takimin pasi që të gjithë anëtarët e komisionit janë prezent dhe raportoje rreth përfilljes se të gjitha procedurave të parapara nga propozuesi, u dha sqarime për kushtet qe kandidati që duhet ti përmbush për këtë çmim sipas Rregullores.

Në shërbimin e Kuvendit kishte arritur vetëm 1 (një) propozim të cilin e hapi Kryesuesi i komisionit dhe e lexoi:

- Propozimi ishte për z. Arsim Kabashi nga Krushica e Ultë për udhëheqje të mirë në sektorin privat, i adresuar nga Kryetari i Komunës

Propozimi kishte të bashkangjitur justifikimi dhe biografën, Komisioni pasi shqyrtoi këtë propozim, vendosi me vota unanimitet që t'i rekomandojë anëtarëve të Kuvendit të Komunës që z. Arsim Kabashi nga Krushica e Ultë për udhëheqje të mirë në sektorin privat, t'i ndahet çmimi “Ukë Bytyçi” për udhëheqje të mirë.

Kryesuesi i Komisionit

Mr.ec Bexhet KUÇI